



**LETËR POZICIONIMI PËR
RAJONALIZIMIN E SHOQËRIVE TË
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE TË
SHQIPËRISË
SHOQATA PËR AUTONOMI VENDORE**

TIRANË, SHTATOR 2022



FALËNDERIME



Shoqata për Autonomi Vendore dëshiron të falënderojë të gjithë donatorët, ekspertët dhe ekipin për punën e palodhur në përgatitjen e kësaj Letre pozicionimi.



Kjo letër pozicionimi është përgatitur në kuadër të projektit “Ofrimi i Produkteve për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime në Shqipëri” i financuar nga Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Shërbimet e Ujësjiellës Kanalizimeve (RCDN).

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
1. Hyrje.....	4
2. HISTORIKU I PROBLEMIT	5
2.1 KONTEKTSI.....	7
2.2 SITUATA AKTUALE.....	8
3. EKSPERIENCA NDËRKOMBËTARE	12
4. SHAV, NJË ALTERNATIVË E DOMOSDOSHME PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE	15
5. OPSIONET E POLITIKAVE	19
6. DEKLARATAT E POLITIKAVE.....	20
Referencat	22

SHKURTIME

AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Menaxhimit të Mbetjeve
BE	Bashkimi European
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
O&M	Operim dhe Mirëmbajtje
RCDN	Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Shërbimet e Ujësjetllës Kanalizimeve
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore
ShaUK	Shoqëri Aksionere Ujësjetllës Kanalizime
SHUKALB	Shoqata e Ujësjetllës Kanalizimeve të Shqipërisë
SKP	Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta
UK	Ujësjetllës Kanalizime

1. HYRJE

Kjo letër pozicionimi është përgatitur në kuadër të projektit “Ofrimi i Produkteve për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime në Shqipëri” i financuar nga Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Shërbimet e Ujësjetllës Kanalizimeve (RCDN).

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimi i stafit përgjegjës në bashki dhe të shoqërive aksionare të Ujësjetllës Kanalizimeve (ShaUK) për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për qytetarët, nëpërmjet ofrimit të produkteve të zhvillimit të kapaciteteve dhe krijimit të bazës për partneritete.

Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) ka mision të mbështesë njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe të mundësojë dialogun mbi problemet e përbashkëta me qëllim gjetjen e zgjidhjeve praktike si dhe të mbrojë interesat e tyre dhe principet e decentralizimit. Ndër objektivat e punës së SHAV është të fuqizojë NJQV nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve dhe ofrimit të produkteve për përmirësimin e performancës.

Një ndër produktet e projektit është zhvillimi i Strategjisë së Advokimit të SHAV, e cila është hartuar dhe ka identifikuar disa tema prioritare për të mbështetur punën e SHAV në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të njësisve vendore lidhur me cëshjet e sektorit të ujit në Shqipëri. Strategjia e Advokimit pasohet nga zhvillimi i një Letre Pozicionimi për temat e identifikuara.

Kjo Letër Pozicionimi ka si qëllim të evidentojë dobinë e rolit aktual dhe të ardhshëm të SHAV në zhvillimin e kapaciteteve për temën e Rajonalizimit. Letra përpiqet të analizojë procesin e rajonalizimit (bashkimit) të ShaUK dhe identifikojë sfidat dhe nevojat që ato se bashku me Qeverinë Qendrore dhe Bashkitë kanë me qëllim gjetjen e zgjidhjeve për një zbatim të suksesshëm të këtij procesi.

Në momentin e hartimit të kësaj letrë pozicionimi në Shqipëri është përcaktuar modeli i bashkimit të Sha UK dhe si rrjedhim letra nxjerr në pah dobinë që sjell dialogu qeveri-pushtet vendor-Sha UK në drejtim të rajonalizimit dhe nevojës për zhvillim kapacitetesh dhe ndërgjegjësim të këtij procesi për rritjen e performancës së sektorit UK.

Letra përqëndrohet në sfidat dhe nevojat që kanë NJQV dhe ShaUK në procesin e riorganizimit duke advokuar mbi mënyrat sesi mund të mbështesë SHAV me ofertën e saj në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve, hartimit të politikave dhe mbrojtjes së interesave të tyre. Një Strategji e përbashkët për advokim është zhvilluar në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive dhe Shoqatën e Ujësjiellës Kanalizimeve (SHUKALB).

2. HISTORIKU I PROBLEMIT

Gjatë 25 viteve të fundit në Shqipëri janë bërë përpjekje të ndryshme për të reformuar sektorin e ujit nisur nga rëndësia që uji ka për jetën sociale, zhvillimin ekonomik dhe strategjik të vendit.

Decentralizimi i ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve tek pushteti vendor i cili ka nisur që në vitin 2000¹ ka kaluar në disa faza dhe ky proces ka ngritur sfida si në drejtim të menaxhimit ashtu dhe financimit. Sfidat dhe përgjegjësitë e menaxhimit të ujit në nivel vendor lidhen me:

- (i) kohën e gjatë të përfundimit të procesit të transferimit të aseteve fillimisht të Bashkitë dhe më pas të shoqëritë UK;
- (ii) fragmentarizimin e sektorit nisur nga numri i lartë i Sha UK krahasuar me popullsinë e shërbyer, çka e bën të vështirë arritjen e ekonomive të shkallës;
- (iii) mungesën e një mekanizmi dhe qasje të integruar për të planifikuar në mënyrë të integruar dhe afatgjatë. Kjo ka bërë që investimet e kryera në sektor ndonëse të shumta të mos prodhojnë efektin e dëshiruar në drejtim të përmirësimit të treguesve të performancës në nivelet e pranueshme sektoriale².

Indikatorët e performancës të sektorit UK tregojnë se në nivel sektori vetëm disa shoqëri arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M), pavarësisht se në nivel sektori mbulohen 100 % për shkak të madhësisë së disa shoqërive. Në Shqipëri nga 58

¹ Hapi specifik më i rëndësishëm ishte miratimi dhe zbatimi i Ligjit Nr. 8652, datë 31.07. 2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”

² Programi Kombëtar Sektorial i Ujit, 208-2030, fq. 8

shoqëri aktive në total në vitin 2021, 44 prej tyre i shërbejnë një popullsie më pak se 50,000 banorë dhe nga këto shoqëri 31 i shërbejnë një popullsie më pak se 22,000

Mesazhi Kryesor

*Në Shqipëri nga 58 shoqëri aktive në total në vitin 2021, 44 prej tyre i shërbejnë një popullsie më pak se 50,000 banorë dhe nga këto shoqëri 31 i shërbejnë një popullsie më pak se 22,000 banorë, çka tregon se ka një **mungesë të theksuar të “ekonomive të shkallës”**.*

banorë, çka tregon se ka një mungesë të theksuar të “ekonomive të shkallës”.

Përveç kësaj ajo që vihet re është se gjatë 2 dekadave të fundit fundit ka migracion drejt zonave urbane duke sugjeruar se ekzistojnë mundësi për

ekonomi të shkallës. Sipas studimit të Tynan (2003:1-14) një faktor shkalle e qëndrueshme është 0.8 që do të thotë se me dyfishimin e prodhimit kostot rriten me 80%. Në përputhje dhe me studime të tjera të kryera në këtë fushë ekzistojnë evidenca se ekonomitë e shkallës arrihen më mirë për kompanitë që janë të vogla në madhësi që ju shërbejnë një popullsie prej 125,000 banorë sesa në kompanitë e mëdha ku efektet e ekonomive të shkallës fillojnë të bien shpejt.

Në Shqipëri sapo ka nisur procesi i riorganizimit të ShaUK që konsiston në mundësinë që dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë (MIE) për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve³.

Në kuadër të këtij procesi disa nga problemet e evidentuara nga sondazhi i realizuar në kuadër të kësaj Letre Pozicionimi për ShaUK lidhen me:

- (i) mosnjohjen e sistemeve të shoqërive të bashkuara kryesisht atyre teknike;
- (ii) procedura burokratike komplekse dhe të lodhshme;
- (iii) mosnjohja e mundësive që vijnë nga bashkëpunimi;
- (iv) mungesa e trajnimeve vecanërisht për stafin teknik dhe financiar;

³ VKM nr. 302 datë 11.5.2022

- (v) mosnjohja e përfitimeve që vijnë nga procesi i riorganizimit.

2.1 KONTEKTSI

Në Shqipëri ekzistojnë dokumenta politikash që lidhen me sektorin e ujit. Sektori i ujit lidhet ngushtë me sektorin e energjisë, zhvillimin e bujqësisë, turizimin. Menaxhimi i integruar i ujit është një ndër prioritet e qeverisë shqiptare në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016) dhe Strategjinë Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027 (miratuar me VKM nr. 73 datë 7.2.2018).

Qeveria Shqiptare ka hartuar Programin Kombëtar Sektorial 2018-2030 nga ku synimet kryesore janë orientimi i investimeve drejt objektivave kombëtarë, përmirësimi i procesit të planifikimit, rritja e investimeve në sektor, rritja e të ardhurave që gjeneron sektori, monitorimi i vazhdueshëm dhe efektiv dhe mbrojtja e ekuilibrave mjedisorë.

Riorganizimi i ShaUK në formën e agregimit të shoqërive është një çështje që është debatuar që në vitin 2011. Rajonalizimi ka qënë synim i Qeverisë Shqiptare në Strategjinë Kombëtare për sektorin UK 2011-2017. Në këtë strategji janë përcaktuar në mënyrë sasiore numri i shoqërive që duhej të bashkoheshin në mënyrë graduale vit pas viti. Konkretisht nga 57 shoqëri UK në vitin 2010 parashikoheshin që ky numër të reduktohej në 26 në vitin 2017 (Strategjia Kombëtare, 2011-2017:39). Agregimi po ashtu del si nevojë në Strategjinë Kombëtare UK 2020-2030.

Ky proces nuk u finalizua sipas përcaktimeve të kësaj strategjie, por u bë realitet sipas përcaktimeve të VKM nr. 302 datë 11.5.2022 për *“Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe për punimit të ujërave të ndotura”*. Qëllimi i riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe punimit të ujërave të ndotura është që të përmirësojë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Sipas këtij vendimi njësitë e vetëqeverisjes vendore që bien dakord për riorganizimin e SHaUK, që ushtrojnë veprimtarinë brenda kufijve të juridiksionit territorial të tyre, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse MIE. Ndërsa shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit organizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (SKP), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele.

Shoqëria e re aksionare ka aksionar kryesor MIE e cila zotëron jo më pak se 51 (pesëdhjetë e një) % të aksioneve me të drejta vote. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë lidhur marrëveshje për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës kanalizimeve në pronësi të tyre, zotërojnë bashkërisht jo më shumë se 49 (dyzet e nëntë) % të aksioneve me të drejta vote të SKP-së së krijuar rishtazi, në përpjesëtim me numrin total të abonentëve aktivë, që kanë shoqëritë aksionare ekzistuese në pronësi të tyre në momentin e nënshkrimit dhe të hyrjes në fuqi të marrëveshjes për krijimin e SKP-së.

MIE nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Menaxhimit të Mbetjeve (AKUM) ka nisur procesin e riorganizimit të sektorit të UK dhe ka nënshkruar disa marrëveshja me disa bashki dhe shoqëri UK përkatëse. Megjithatë ky proces kërkon kohë, investime të mëdha dhe bashkëpunim dhe kordinim për të prodhuar efektet e duhura.

2.2 SITUATA AKTUALE

Sipas raportit më të fundit të performancës përgatitur nga ERRU për vitin 2021, 80% e SHaUK nuk arrijnë ti mbulojnë kostot operative me të ardhurat e faturuara dhe kjo situatë sjell përkeqësim gjithashtu të detyrimeve të prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së të cilat akumulohen çdo vit duke shtuar llogaritë e pagueshme edhe pse qeveria qendrore vazhdon të subvencionojë këto shoqëri. Sektori UK vazhdon të jetë larg mbulimit 100% të Kostove Totale.

Sipas raportit të performancës të Entit Rregullator të Ujit, për vitin 2021 treguesit e performancës tregojnë problematika të sektorit ndonëse treguesit janë përmirësuar nga viti në vit. Treguesi “Mbulimi i Kostove O&M” 103.4% paraqitet në nivel performance të mirë me një përmirësim të lehtë, por sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM pasi vetëm 12 nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M. Rezultatja del pozitive për sektorin pasi disa nga shoqëritë e mëdha duke filluar nga UK Tiranë. Korçë, Berat- Kuçovë mbulojnë mbi 100% kostot e O&M.

Me përmirësim të ndjeshëm me 1,6 orë/ditë paraqitet “Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë” duke arritur nivelin mesatarisht 15.4 orë/ditë. Po kështu edhe Treguesi “Uji Pa të Ardhura” në nivelin e 64.8% megjithëse ka një përmirësim të lehtë, përsëri mbetet në nivele mjaft të larta.

Tabela nr.1: Treguesit e performancës për vitin 2021

Indikatorët e Performancës	2021	Standarti sipas ERRU
Uji pa të ardhura (%)	64.8	30
Mbulimi i Kostove O&M (%)	103.4	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	73.9	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	92.3	82
Norma e Arkëtimit Korrente (%)	77.6	82
Niveli i matjes (%)	80.7	85
Eficienca e stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.9	4/6/10
Kohëzgjatja e furnizimit me ujë (orë/ditë)	15.4	18
Mbulimi me Kanalizime (%)	52	75
Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.8	n/a

Burimi: Raporti Performancës 2021, Erru⁴

Mbështetur në situatën problematike të sektorit UK sic e tregojnë indikatorët e performancës, Qeveria Shqiptare në maj 2022 mori vendimin për riorganizimin e sektorit UK me qëllimin që shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane. Modeli

⁴ https://www.erru.al/doc/Raporti_Performances_2021.pdf

i përzgjedhur në vendimin e Qeverisë për bashkimin e shoqërive është mbi baza vullnetare. Qeveria Shqiptare e ka bërë transparente publikisht nevojën për riorganizimin dhe procesin sesi do të funksionojë.


Shoqëritë e reja rajonale të krijuara deri më tani janë 12 nga 15 të parashikuara në Vendimin e Qeverisë si më poshtë:

- ❖ Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a dhe në këtë shoqëri bëjnë pjesë bashkitë: Durrës, Kavajë, Rogozhinë, Shijak dhe Krujë.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Elbasan, e cila do t'i shërbejë bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Belsh dhe Peqin.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Berat, e cila do ti shërbejë bashkive Kucovë, Dimal, Polican dhe Skrapar.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Korçë, e cila do ti shërbejë bashkive Korçë, Devoll, Maliq, Kolonjë dhe Pustec.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Fier, e cila do t'i shërbejë bashkive Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Lushnjë, e cila do t'i shërbejë bashkive Lushnjë dhe Divjakë
- ❖ Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sha dhe në këtë shoqëri bëjnë pjesë bashkitë: Delvinë, Finiq dhe Konispol.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Lezhë, e cila do t'i shërbejë bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër, e cila do t'i shërbejë bashkive Gjirokastër. Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe Memaliaj.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Dibër, e cila do t'i shërbejë bashkive Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Pogradec, e cila do ti shërbejë bashkive Pogradec dhe Përrenjas.
- ❖ Shoqëria Rajonale UK Kukës, e cila do t'i shërbejë bashkive Kukës, Tropojë dhe Has.

Në përputhje me nenin 7 të VKM nr.302 datë 11.5.2022 përfaqësuesit ligjorë të ShaUK, me propozimin dhe mbështetjen e AKUM do të caktojnë një ekspert të pavarur për të vlerësuar e asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK. Bilanci i transferimit të konsiderohet bilanci i datës 31.12.2021.

Data e transferimit efektiv, në të cilën aktivitetet do të konsiderohen të kryera nga shoqëria SKP do të jetë dita e 45-të nga njoftimi i drejtorive tatimore.

Grafiku nr.1: Shoqëritë e reja rajonale të krijuara deri në Shtator 2022



Burimi: Të dhënat për numrin e lidhjeve nga Raporti i Performancës 2021, ERRU fq.29

Duke analizuar 12 shoqëritë e reja rajonale disa karakteristika mund të evidentohen:

1. Shoqëritë e reja të krijuara kanë një madhësi sipas numrit të lidhjeve, e cila ndihmon në arritjen e ekonomive të shkallës.
2. Krijimi i shoqërive rajonale rrit mundësitë për të patur akses në përfitimin e fondeve financiare duke ju krijuar mundësi njësive më të vogla që të investojnë në rrjetet e tyre të amortizuara dhe të dedikojnë fonde për mirëmbajtjen.
3. Bashkimi është realizuar ndërmjet një shoqërie financiarisht të qëndrueshme me një ose disa shoqëri me performancë financiare më të dobët.

4. Mbështetja e qeverisë qendrore do të jetë e nevojshme për të mbështetur shoqëritë më të vogla me grante, ose subvencionimin e një pjese të tarifës, e cila mund të ndryshojë me krijimin e shoqërive të reja.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të stafit sipas programit kombëtar të sektorit 2018-2030 vlerësohet se është investuar për ngritjen e kapaciteteve me anë të programeve dhe projekteve të ndryshme të trajnimit, të cilat kanë dhënë një mbështetje të konsiderueshme përgjithësisht për nivelin politikbërës. Rrjedhimisht, sektori i ujit ka ende nevojë për ngritje kapacitetesh në të gjitha nivelet qeverisëse. Ky vlerësim është kryer përpara riorganizimit të shoqërive UK. Në kushtet kur rajonalizimi, i cili kryhet për herë të parë në Shqipëri sapo ka nisur, ngritja e kapaciteteve bëhet vecanërisht e domosdoshme për njësitë e pushtetit vendor, shoqëritë ujësjellës kanalizime, publiku i gjerë etj në drejtim të ndryshimeve, efekteve rajonale dhe mundësitë që ofrohen nga ky proces.

3. EKSPERIENCA NDËRKOMBËTARE

Eksperienca ndërkombëtare ka treguar se me futjen e konceptit të menaxhimit të integruar të ujit, bashkimi i kompanive bëhet një domosdoshmëri pasi kërkohet zhvillim dhe menaxhim në mënyrë të koordinuar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, me qëllim maksimizimin e mirëqënies ekonomike dhe sociale në një mënyrë të barabartë pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Për shembull në Mbretërinë e Bashkuar dhe Wales rritja ekonomike dhe shfaqja e problemeve të ndotjes detyroi qeverinë qendrore që të riorganizonte menaxhimin e burimeve ujore duke bashkuar më shumë se 200 kompani të ujit dhe 1400 kompani të kanalizimeve në vetëm 10 kompani rajonale. Këto kompani kishin si objektiv të menaxhonin ujërat në mënyrë të integruar dhe po ashtu dhe shërbimet e kanalizimeve (Kingdom, 2005:12).

Sipas McFarlane (2003:7) përfitimi financiar sigurohet nga ndërvarësia gjeografike që nënkupton faktin se disa zona mund të kenë probleme në të pasurit akses ndaj burimeve ujore dhe në këtë mënyrë bashkimi i kompanive të ujit mundëson akses nga zonat që nuk kanë mundësi të aksesojnë ujërat.

Seksioni në vijim përmbledh raste studimore mbi eksperiencat e disa vendeve në drejtim të rajonalizimit, një punë studimore e kryer nga Kingdom (2005:5-31) për Francën, Hollandën, Italinë dhe kompania konsulente PADECO CO.Ltd për Kosovën dhe Italinë.

Franca

Modeli i rajonalizimit një model i konsoliduar i quajtur modeli i “sindikatave” që konsiston në kompani rajonale të krijuara për të ofruar shërbimet e UK dhe përfshijnë kompani të vogla në madhësi të afërta gjeografikisht (fqinje). Proçesi është zhvilluar tërësisht mbi baza vullnetare, megjithatë prefektët si përfaqësues të pushtetit qendror kanë autoritetin për të “detyruar” bashkitë që të bëhen pjesë e bashkimit. Një ndër rajonet më të mëdha të krijuara është Sindikata e Ujit në Strasbourg (SDEA), e cila u krijua në vitin 1939 nga grupimi i 55 bashkive të ngashme në madhësi dhe rajoni është rritur duke arritur të ofrojë shërbime për 453 njësi vendore për një popullsi rreth 655,000 banorë.

Hollanda

Proçesi i rajonalizimit ka nisur në vitin 1965. Ligji lejon pushtetin qendror që të organizojë rajonalizimin në rast se bashkitë nuk janë të suksesshme për të realizuar këtë proçes. Kriteri kryesor për të realizuar rajonalizimin është se ç’do kompani e ujit duhet të ketë të paktën 100,000 lidhje për të siguruar ujin në një zonë më të madhe, si dhe laboratorët përkatës për kontrollin e cilësisë. Numri i kompanive që janë bashkuar deri më sot është 180, duke krijuar 40 rajone në vitin 1994 dhe 13 rajone në vitin 2008. Fenomeni që vihet re në këtë rast është verifikimi fillimisht i përfitimeve dhe më pas zgjerimi i bashkimit.

Modeli i rajonalizimit në Hollandë përfshin kompani rajonale që ofrojnë vetëm shërbimin e ujit, ndërkohë që shërbimi i kanalizimeve ofrohet nga bordet e ujit. Një kompani tipike rajonale ju shërben 200,000-600,000 konsumatorëve të lidhur me rrjetin dhe ka nga 1-40 përfaqësues si aksionerë. Lidhur me pronësinë e asetëve në disa raste këto janë në pronësinë e kompanive dhe në raste të tjera në pronësinë e pushtetit vendor. Sistemi tarifor është uniform në territorin ku ofrohet i njëjti shërbim. Në vitin 1985 u hartua një plan për riorganizimin dhe krijimin e tre rajoneve të mëdha, por ndeshi në rezistencë të 35 kompanive, të cilat hezitonin për t’u bashkuar. Ky plan u finalizua në vitin 1991.

Italia

Përpara miratimit të ligjit Galli të vitit 1994 shërbimet e ujit ishin të copëzuara vertikalisht dhe horizontalisht, ekzistonin 13,000 operatorë të ndryshëm dhe mesatarisht kompanitë ofronin shërbimin e ujit për 9000 banorë. Ligji parashikonte që bashkimi të bëhej mbi bazat e aksesit në basenet ujore dhe si rezultat u identifikuan 91 kufij territorialë optimalë. Sikurse vihet re *faktori kryesor nxitës për këtë proces ishte përmirësimi i menaxhimit të ujërave në përputhje me Direktivën Europiane të Ujit*. Mbi bazën e ligjit kryesor u hartuan akte të tjera nënligjore në nivel rajonal të cilat zgjatën në kohë nga viti 1995 deri në 2002. Proçesi i rajonalizimit ishte i ngadaltë për shkak të interesave politike në nivel vendor dhe të interesave të sektorit privat.

Rajoni i Lazios është një shembull pozitiv në drejtim të zbatimit të ligjit Galli. Përpara krijimit të rajonit, ekzistonin 436 kompani individuale që ju shërbenin 377 komunave. Ky rajon identifikoi 5 kufij territorialë hidrologjikë, të cilët *përkojnë me kufijtë administrativë*. Sipas ligjit të rajoneve secila zonë territoriale lidhi kontratë me një operator të vetëm. Zona Frosinone i shërben 550,000 banorëve (86 bashkive dhe 3 provinca) dhe ishte e para që ja delegoi përgjegjësinë një operatori privat me anë të një kontrate konçensionari për 29 vjet. Numri më i madh i bashkive të asociuara në 1 zonë territoriale optimale të vetme është në rajonin e Sardenjës (377 bashki), ndërsa rajoni i Lombardisë ka një zonë territoriale optimale me një bashki të vetme atë të Milanos.

Proçesi i rajonalizimit merr dy forma:

- (i) konsorciumi që konsiston në krijimin e një kompanie publike të ujit e krijuar nga vetë njësitë vendore që ka autoritetin ligjor dhe autonominë organizative dhe
- (ii) rënia dakord ose marrëveshja që konsiston thjesht në nënshkrimin e një marrëveshje ndërmjet njësite ekzistuese ku rajoni cakton një organizatë përgjegjëse vendore për të koordinuar njësitë.

Sipas ligjit të ri asetet janë në pronësi të zonave territoriale optimale. Autoriteti për të caktuar tarifën i përket zonës optimale brenda së cilës zbatohet tarifë uniforme. Ndërkohë zonat që kanë patur tarifa të ulta përpara se të bashkoheshin trajtohen si raste të veçanta.

Kosova

Deri në vitin 1999 kur Kosova ishte pjesë e Republikës së Serbisë ofrimi i shërbimit të ujit dhe kanalizimeve ishin përgjegjësi e pushtetit vendor nën mbikqyrjen e Ministrisë së Pushtetit Vendor. Në vitin 2002 nën autoritetin e UNMIK u krijua Agjencia e Mirëbesimit të Kosovës (AMK) me qëllimin e administrimit të ndërmarrjeve publike. Në vitin 2002 AMK prezantoi një strategji për rajonalizimin e sektorit të UK për të bashkuar 34 kompani dhe për të krijuar rajone. Në këtë drejtim u krijuan 7 rajone të regjistruara si kompani tregëtare sh.a, të cilat deri në shpalljen e pavarësisë ishin nën administrimin e AMK-së.

Mësime të nxjerra nga eksperiencia ndërkombëtare

Tendenca e përgjithshme në të gjitha rastet është zhvendosja drejt rajonalizimit. Në shumicën e rasteve arsyet e bashkimit janë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, arritja e ekonomive të shkallës për shkak se kompanitë janë të madhësive të vogla. Në vende si Kosova rajonalizimi krijonte lehtësira për të siguruar financime.

Mësimi kryesor

Në shumicën e rasteve arsyet e bashkimit janë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, arritja e ekonomive të shkallës për shkak se kompanitë janë të madhësive të vogla. Në vende si Kosova rajonalizimi krijonte lehtësira për të siguruar financime.

Bashkimi vetëm mbi baza vullnetare nga ana e njërive të pushtetit vendor është mënyra më e dëshiruar, por kërkon një kohë të gjatë për t'u realizuar psh. rasti i Francës. Bashkimi vullnetar ishte një tipar i

konstatuar në vendet e zhvilluara me një eksperiencë të gjatë në fushën e decentralizimit si Franca, Holanda. Në ato vende ku rajonalizimi vullnetar shfaqte konflikte ndërhyrja e pushtetit qendror ishte një domosdoshmëri (Holanda).

4. SHAV, NJË ALTERNATIVË E DOMOSDOSHMË PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE

Për nga vetë misioni që SHAV ka dhe nisur nga eksperiencia e fituar ndër vite është provuar se fuqizimi i kapaciteve të pushtetit vendor për të rregulluar dhe drejtuar çështjet publike me karakter lokal përbën faktorin kryesor të suksesit.

Ndërtimi i kapaciteteve është një proces i vazhdueshëm, thelbësor në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit aq më tepër kur sektori UK sapo ka hyrë në fazën e riorganizimit (bashkimit) dhe ku partneriteti dhe kordinimi me aktorë të ndryshëm në nivel vendor dhe qendror janë pjesë e axhendës së punës së pushtetit vendor dhe shoqërive të reja rajonale UK.

SHAV ka një eksperiencë 20 vjecare në lidhje me çështjet e pushtetit vendor përfshirë dhe ato të ujësllës kanalizimeve. SHAV është një institucion që eksperiencën dhe njohurinë e ka zhvilluar përmes forumeve ad hoc të ngritura për çështje specifike që përbëjnë problem publik me karakter lokal, tryezave të rrumbullakëta që tërheqin ekspertët më të mirë vendas dhe ndërkombëtarë në kuadër të partneriteteve me rrjete rajonale dhe europiane.

SHAV ka krijuar njohurinë përmes kontributit të dhënë ndaj reformave që janë ndërmarrë në fushën e decentralizimit, riorganizimit territorial (2015) dhe si e tillë ka aftësinë në drejtim të strukturimit të dialogut për të gjithë aktorët në çështjet e decentralizimit dhe ofrimit të shërbimeve nga NJQV dhe ShaUK.

Që kur është themeluar SHAV ka qënë pjesë e rrjeteve të ndryshme ndërkombëtare, programeve, strategjive dhe projekteve në fushën e fuqizimit të strukturave të pushtetit vendor të tilla si⁵:

- 2015, Projekti me Këshillin e Europës për fuqizimin e ekspertëve lokal për vlerësimin institucional.
- 2016- aktualisht, anëtar i projektit për “Përmirësimin e strukturave pyjore vendore me qëllim rritjen e të ardhurave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale”.
- 2017- aktualisht, anëtar me të drejta të plota të këshillit konsultativ që ka si synim përmirësimin e marrëdhënieve të pushtetit qendror dhe atij vendor, propozimin e nevojave lokale dhe dhënia e mbështetjes për ligjet dhe aktet nën-ligjore.
- 2019- aktualisht, anëtar i rrjetit të shoqatave të autoriteteve vendore në Europën Juglindore (NALAS). Rrjeti sjell së bashku 14 Shoqata që përfaqësojnë rreth 9000

⁵ Lista e projekteve është mjaft e gjatë dhe në këtë rubrikë paraqiten vetëm disa prej tyre.

autoritete vendore të zgjedhur drejtpërsëdrejti nga më shumë se 80 milionë qytetarë.

- 2019- aktualisht, anëtar i Komitetit mbikqyrës të programit të zhvillimit rajonal në Shqipëri. Ky program ka si synim të përmirësojë kapacitetet lokale dhe rajonale sipas nevojave dhe potencialit duke mbështetur iniciativat e nxitura nga Zhvillimi duke përmirësuar aksesin ndaj shërbimeve sociale, dhënien e rekomandimeve për draftimin e kuadrit të ri ligjor për zhvillimin rajonal.
- Janar 2020-Dhjetor 2020, partner në projektin Bashki të Forta-që ka si synim të mbështesë bashkitë për identifikimin e risqeve të parashikuara në ligj dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e funksionit të emergjencave në strukturat e pushtetit vendor.
- 2021-aktualisht, partner në projektin Bashki të Forta duke dhënë mbështetje për hartimin e listës së standarteve të indikatorëve për shërbimet bashkiake.
- 2021-aktualisht, partner në projektin Bashki të Forta që ka si synim identifikimin e mangësive dhe zgjidhjeve të NJQV në drejtim të zbatimit të politikës së decentralizimit dhe funksioneve qeverisëse të pushtetit vendor gjetjet e së cilës kontribuan në hartimin e strategjisë së re të decentralizimit 2023-2030 dhe në përgatitjen e letrës së pozicionimit që reflekton këndvështrimet e pushtetit vendor, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit kërkimor.
- Tetor 2021- Dhjetor 2021, mbështetje për sistemin e menaxhimit të njohurisë RCDN që ka si qëllim të mbledhë, organizojë dhe sistematizojë njohurinë dhe ta bëjë të aksesueshme për komunitetin. SHAV ka qënë një pikë kyce e sistemit të njohurisë me informacion për Shqipërinë duke grumbulluar dhe zhvilluar praktikat më të mira dhe modelet, të cilat ndahen me komunitetin vendor (bashki dhe shoqëri ujësjellës kanalizime) duke dhënë opinione për politikat lokale dhe për përmirësimin e kuadrit ligjor.
- 2021- aktualisht, pikë kyce për projektin rajonal “Fuqizimi i kapaciteteve në drejtim të ofrimit të shërbimeve dhe kuadrit të duhur ligjor në fushën e kanalizimeve në kuadër të projektit rajonal për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e ujit dhe kanalizimeve” që zbatohet nga NALAS dhe financohet nga GIZ. SHAV ka dhënë mbështetje dhe ka qënë pjesë e debateve, konferencave dhe një avokat për rolin

e shoqatave vendore në drejtim të transparencës dhe demokratizimit të reformave lokale.

- 2022-aktualisht, anëtare e EU 4 Tranzicionit të Energjisë që ka si synim të mbështesë besëlidhjen e kryebashkiakëve të qyteteve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në drejtim të objektivave të energjisë dhe të klimës.

OFERTA E SHAV PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE

Vet-administrimi lokal

- Parimet e qeverisjes lokale
- Decentralizimi fiskal
- Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve
- Autonomia financiare
- Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe lokale
- Qeverisje e hapur, transparenca dhe mekanizmat e llogaridhënies (përfshirë e-qeverisja).
- Menaxhimi i Emergjencave Civile
- Menaxhimi i risqeve publike

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

- Menaxhimi i Integruar i Aseteve
- Shërbimi i Klientit dhe Marrëdhëniet me Publikun
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Menaxhimi i Performancës nëpërmjet Benchmarking
- Projektet e investimeve kapitale në infrastrukturë në sektorin e UK

Zhvillimi i qëndrueshëm vendor

- Reforma administrative-territoriale
- Menaxhimi financiar në nivel vendor
- Qeverisja e mirë në nivel vendor
- Efikasiteti dhe efienca e të ardhurave vendore
- Zhvillimi i kapaciteteve të njësive vendore.

Llogaridhënia dhe monitorimi

- Monitorimi dhe vlerësimi
- Raportimi dhe llogaridhënia
- Transparenca dhe informimi i Publikut

- Uji pa të ardhura
- Indikatorët e performancës dhe kontratat me bazë performance.

5. OPSIONET E POLITIKAVE

Siç njihet gjerësisht nga literatura dhe praktika, uji si shërbim është i decentralizuar në nivel vendor. Uji përveçse është një e drejtë bazike për secilin individ është në të njëjtën kohë një mall i tregëtueshëm. Në këtë drejtim, proçesi i ofrimit të shërbimit të ujit është në juridiksionin e kuadrit ligjor për decentralizimin. Por, ky burim duhet të menaxhohet si duhet për t'ju krijuar mundësinë brezave të ardhshëm që të kenë po të njëjtin akses, pra menaxhimi i tij duhet të jetë i qëndrueshëm.

Në Shqipëri riorganizimi i sektorit UK mbart me vete një kuadër të ri ligjor që do të rregullojë bashkimin e ShaUK në cdo aspekt të tij. Ky proçes megjithë avantazhet e tij shoqërohet me sfida dhe nevojë të mëdha për investime, të cilat duhet të bëhen pjesë e Strategjisë Sektoriale UK. Ekzistenca e aktorëve të shumtë që preken nga ky proçes ngre nevojën e përfshirjes së tyre gjatë zbatimit të vendimit të qeverisë, marrëveshjeve të nënshkruara mes palëve dhe akteve të tjera nënligjore që mund të hartohen në të ardhmen.

Shoqëritë e reja rajonale ndeshen me një territor më të madh për tu menaxhuar dhe ekzistenca e asetëve të amortizuara e bën më të vështirë menaxhimin. Shoqëritë rajonale për funksione të vecanta si ai i shitjes do të duhet të synojnë investime në teknologji smart për të ulur kostot dhe rritur të ardhurat.

Rajonalizimi i Sha UK është proces i ri i panjohur më parë në realitetin shqiptar. Ndryshimi i skemës së organizimit të shoqërive të reja rajonale ndonëse është bërë publik kohë më parë shoqërohet me paqartësi vecanërisht mbi efektet rajonale që prodhon rajonalizimi, përfitimet, vështirësitë dhe mundësitë që ky proçes ofron në periudhë afat-gjatë. Për këtë

janë të nevojshme fushatat ndërgjegjësuere dhe asistencë teknike për forcimin e kapaciteteve në drejtim të menaxhimit dhe përmirësimit institucional.

Krijimi i shoqërive të reja rajonale përbën mundësi për thithjen e fondeve rajonale për menaxhimin e integruar të ujit. Qeveria Shqiptare përmes AKUM dhe MIE në bashkëpunim me njësitë e pushtetit vendor do të duhet të sigurojnë asistencë teknike për ngritjen e kapaciteteve për aksesin ndaj granteve/huave rajonale nga institucionet ndërkombëtare dhe BE-ja. Po kështu, AKUM dhe MIE do të duhet të rrisin kontributin nga buxheti i shtetit për investime infrastrukturore dhe të vazhdojnë të japin subvencione të përkohshme për mbulimin e deficitit financiar.

Bashkimi i ShaUK konsiston në bashkimin edhe të burimeve njerëzore. Shoqëria e re që krijohet përfiton nga stafi më i kualifikuar, të cilët sjellin me vete njohuri, por nga ana tjetër ndeshet me një pjesë të stafit që kanë nevojë për zhvillim profesional. Do të jetë e nevojshme përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësi të gjithë stafit në kuadër të shoqërisë së re rajonale.

6. DEKLARATAT E POLITIKAVE

Për zbatimin e procesit të rajonalizimit duhet që të krijohet **një rrjet profesionistësh gjithëpërfshirës për ndarjen e eksperiencave** dhe sfidave me të cilat ndeshen shoqëritë e reja rajonale. Ky rrjet do të krijonte një mundësi për SHAV për të ndarë njohurinë dhe për të sjellë ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë. Ky rrjet sugjerohet të iniciohet nga SHAV me perspektivën që vetë shoqëritë e reja rajonale të kenë pronësinë e administrimit të tij. Ekziston mundësia që rrjeti të drejtohet mbi bazën e rotacionit të secilës shoqëri rajonale me strukturë mbikqyrëse SHAV. SHAV ka mundësi që të krijojë **bibliotekën online për çështjet e rajonalizimit**, e cila do të duhet të pasurohet me raste studimi të vendeve të tjera, të cilat e kanë kaluar apo janë në fazën e rajonalizimit.

Me qëllim zhvillimin e politikave, strategjive, përmirësimit e kuadrit ligjor SHAV duhet të zgjerohet **fushën e forumeve të saj profesionale duke krijuar forume të dedikuara për ujësjellës kanalizime**, të cilat do të shërbejnë si hub profesionale dhe që përfshijnë

ekspertë nga fusha të ndryshme përfshirë dhe përfaqësues të pushtetit qendror, vendor dhe shoqërisë civile.

Megjithë përpjekjet e Qeverisë për të azhornuar strategjinë sektoriale dhe hartuar ligj të ri ende nuk është bërë miratimi i këtyre dokumentave. **SHAV duhet të advokojë për azhornimin e strategjisë sektoriale 2018-2030 për të përfshirë procesin e rajonalizimit të shoqërive UK** dhe për miratimin e projekt ligjit të ri në këtë këndvështrim. Eshtë e domosdoshme që Strategjia të përfshijë planin përkatës të investimeve për të gjitha shoqëritë rajonale.

SHAV duhet të bashkëpunojë me AKUM me njohurinë e saj për **hartimin e programeve të rritjes së ndërgjegjesimit** për konsumatorët dhe NJQV lidhur me procesin e rajonalizimit duke ndarë përfitimet, mundësitë, vështirësitë që vijnë nga ky proces dhe për të nxitur pjesëmarrjen e aktorëve që të bashkëpunojnë për zbatimin me sukses të këtij procesi.

SHAV duhet të bashkëpunojë me AKUM për të ndihmuar në drejtim të **hartimit të një manuali mbi rolet dhe përgjegjësitë e funksioneve kyce në shoqëritë e reja rajonale** dhe mbi procesin e ndërveprimit mes pushtetit qendror, vendor dhe shoqërisë rajonale.

Së fundmi, **SHAV duhet të krijojë partneritete me donatorë të huaj dhe të aksesojë sa më shumë fonde për të mbështetur NJQV dhe shoqëritë e reja rajonale** me programe të asistencës teknike për trajnime, hartimin e planeve institucionale, hartimin e rregulloreve të brendshme etj. SHAV duhet të shohë mundësinë që këtë rol ta kryejë në bashkëpunim me SHUKALB.

REFERENCAT

ERRU (2022): Raporti Vjetor 2021

Kingdom, W. (2005). Models of Aggregation for Water and Sanitation Provision. *Water Supply and Sanitation Notes*, Note No. 1, fq. 5-31.

Ligjit Nr. 8652, datë 31.07. 2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”

McFarlane S. (2003). Regional Water Works: sharing urban water services. *Western Cities Project Report #28*, f.7.

Padeco CO, LTD. (2009). Feasibility Study of Regional Utilities in the Water and Wastewater Sector of Albania, f. 13.

Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030

[http://ujesjellesitirane.al/wp-](http://ujesjellesitirane.al/wp-content/uploads/2018/02/Programi%20Komb%20Sektorial%20i%20Ujit.pdf)

[content/uploads/2018/02/Programi%20Komb%20Sektorial%20i%20Ujit.pdf](http://ujesjellesitirane.al/wp-content/uploads/2018/02/Programi%20Komb%20Sektorial%20i%20Ujit.pdf)

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027 (miratuar me VKM nr. 73 datë 7.2.2018).

<http://ambu.gov.al/public/STRATEGJIA%20KOMB%20BTARE%20P%20BR%20MENAXHIMIN%20E%20INTEGRUAR%20T%20BURIMEVE%20UJORE.pdf>

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016)

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3884&token=34c2151dcaaafa349241814499a02c11026ae4c>

Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2011-2017:39

https://www.erru.al/doc/Strategjia_Kombetare_e_Furnizimit_me_UK.pdf

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030: 25-26

<https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Strategjia-UK-2020-2030.pdf>

Tynan, N. (2003). Returns to Scale in Water Systems in Developing Countries: Some Econometric Evidence processed, World Bank paper, fq. 1-14.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302 datë 11.5.2022 “Për Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.